



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 9, Datë 10.01.2018

MBI

MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORÇA” SH.P.K PËR VENDOSJE TË HIPOTEKËS MBI SENDET E PALUAJTSHME TË SHOQËRISË PRANË INTESA SANPAOLO BANK.

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; si dhe të pikës 1.3 të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për vendosje të hipotekës mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 139, datë 06.09.2017 vendosi:
 1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k për vendosje të hipotekës mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.
 2. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit dhe sendet e luajtshme.
- ERE me shkresën nr. 569/1 Prot., datë 13.09.2017, ka njoftuar shoqërinë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k për vendimmarrjen e sipërcituar dhe ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar nga ky subjekt brenda dy muajve sipas përcaktimit të nenit 10 pika 2 të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”.
- Shoqëria “Hydro Power Plant of Korça”, paraqiti në ERE plotësim të dokumentacionit të munguar sa i përket nenit 7 pika 3 të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit” dhe me shkresën nr. 703 Prot, datë 07.12.2017 kërkoi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së saj me 7 ditë.
- Në vijim, me shkresën nr. 705 Prot., datë 11.12.2017, shoqëria “Hydro Power Plant Of Korça” sh.p.k depozitoi në ERE plotësimin e dokumentacionit për nenin 7 pika 1 gërma “i”, me shkresën e “Intesa Sanpaolo Bank” me nr. 17/61180 Prot., datë 07.12.2017.

- Pas depozitimit të të gjithë dokumentave të munguar, aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit” si më poshtë :
 - Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 7 pika 3, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k për vendosje të hipotekës mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë, pranë Intesa Sanpaolo Bank. (lista bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Lista e kolateralit qe do te bllokohet ne hipoteke ne favor te INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA per kredine e projektit te HEC Verbe – Selces

Me poshte eshte lista e kolateralit te pasurive te patundshme qe do te barresohen ne hipoteke ne favour te INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA per efekt te marrjes se kredise per projektin e HEC te Verbe - Selces.

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2, Fq. 216

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **501/2**

Lloji i pasurise "are 190 m² dhe "truall" 45.2 m².

1. Kalon traseja e tubacionit te mbuluar te turbines HEC Verba 1;

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2 Fq. 222

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **496/4**

Lloji i pasurise Truall 331.3 m² , siperfaqe totale 1400 m².

Kalon tubacioni nentokesor dhe veprat hidroteknike te HEC Verba 1

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2 Fq. 219

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **502/2**

Lloji i pasurise totale 140 m², truall 37.6 m²

Kalon tubacioni nentokesor dhe veprat hidroteknike te HEC Verba 1

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 2 dhe nenstacioni, Vol 2 Fq. 214

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **720/2**

Lloji i pasurise Truall 1000 m².

Eshte vendosur ndertesa e HEC Verba 2 me siperfaqe 290 m² me agregatet turbine gjenerator dhe nenstacioni ngrites 10/35 kV me te gjitha pajisjet e tij.

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 2, Vol 2 Fq. 226

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **720/3**

Lloji i pasurise Truall 940 m².

Jane vendosur kanali derivacionit, baseni presionit dhe tubacioni netokesor i turbines 2300 m te HEC Verba 2.

HPP of KORCA sh.p.k.

Ad: Bulevardi "BajramCurri", Pallati "Palma e Arte " kati 1, perballë Gjyqates se Tiranes, Tel: ++355 692056519